

**Ac.nr.3274/2013**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Qerim Ademaj, kryetar i kolegjit , Fejzullah Rexhepi dhe Albert Zogaj, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit N.H. nga fshati ..., Komuna e Shtërpcës, të cilin e përfaqëson A.I. avokat në Ferizaj, sipas autorizimit, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “ I” me seli në Prishtinë, për kompensim të dëmi nga baza e auto përgjegjësisë, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik, C.nr.7/11 i datës 11.09.2013, në seancën e kolegjit të mbajtur me date 20.07.2016, mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

Refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “ I” me seli në Prishtinë, dhe **VERTETOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik, C.nr.7/11 i datës 11.09.2013, përveç në pjesën e kërkesëpadsisë lidhur më kompensimin e dëmit material për shërimin rehabilitues dhe shpenzimeve të mjekimit, për të cilën ankesa e të paditurës aprovohet si e bazuar dhe aktgjykimi i ankimuar në këtë pjesë **NDRYSHOHET**, ku gjykohet si në vijim: **DETYROHET** e paditura Kompania e Sigurimeve “ I”, me seli në Prishtinë, që paditësit N.H. nga fshati ..., Komuna e Shtërpcës si pasojë e lëndimeve të shkaktuara në aksidentin e komunikacionit i cili ka ndodhur më datë 17.02.2010, në emër të shërimit rehabilitues t’ia paguaj shumën prej 105 euro dhe në emër të shpenzimeve të mjekimit shumën prej 25.90 euro, ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadsisë përtej shumave të gjykuara, refuzohet si e pabazuar.

### **A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik, më aktgjykimin e ankimuar, C.nr.7/11 i datës 11.09.2013, me pikën I të dispozitivit ka vendosur që të miratojë pjesërisht si të bazuar kërkesëpadsinë e paditësit N.H. nga fshati ..., Komuna e Shtërpcës dhe detyrohet e paditura KS ,, I ‘’ me seli në Prishtinë, që paditësit në emër të dëmit material dhe jo material të pësuar si pasojë e lëndimeve të shkaktuara në aksidentin e komunikacionit i cili ka ndodhur më datë 17.02.2010, t’ia paguaj dhe atë:

Dëmin jo material, për dhimbje trupore-fizike shumën prej 2.500 euro dhe për frikën e shkaktuar në shumën prej 2.000 euro.

Dëmin material, për ndihmën e personit të tretë shumën prej 20 euro, ushqim të përforcuar shumën prej 100 euro, shërim rehabilitues shumën prej 280 euro dhe shpenzime të shërimit shumën prej 26 euro.

E të gjitha këto shuma më kamatë si për mjetet e deponuara në bankë pa destinacion të caktuar të afatizuara mbi një vit duke filluar prej datës 11.09.2013 e gjer ne pagesën definitive.

Me pikën II të dispozitivit ka vendosur qe të refuzohet si e pa bazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë mbi shumën e gjykuar dhe atë, për dhimbje fizike shuma prej 500 euro, frikë shuma prej 1.000 euro, për ushqim të përforcuar shuma prej 50 euro, për rehabilitim dhe shpenzime të mjekimit shuma prej 194 euro.

Me pikën III të dispozitivit ka vendosur qe të detyrohet e paditura qe paditësit t'ia paguaj shumat e gjykuar në pikën I/a dhe I/b të dispozitivit, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 883.00 euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit në dorëzim, nën kërcenim të përmbarimit më dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi lidhur më pjesën aprovuese të kërkesëpadisë, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditura, duke e goditur për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim bërë Gjykatës së Apelit që aktgjykimi i goditur të ndryshohet ose të priset dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe vendosje.

I autorizuari i paditësit nuk ka paraqitur përgjigje në ankesën e të paditurës.

Gjykata e Apelit e Kosovës pas ekzaminimit dhe vlerësimit të aktvendimit të ankimuar konform dispozitës ligjore te nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

**-Ankesa e të paditurës është pjesërisht e bazuar.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se Gjykata e shkallës së parë më administrimin e provave shkresore ka gjetur se më datë 17.02.2010 rreth orës 17:50 në rrugën Fusha e pajtimit në Shtërpçë kishte ndodhur aksidenti i trafikut në të cilin ishin të përfshirë vetura e markës VW Golf me targa te regjistrimit... të cilën e drejtonte i siguruari i të paditurës S.M. nga Obiliqi dhe vetura e markës Ford me targa te regjistrimit... të cilën e drejtonte këtu paditësi N.H. nga fshati ... Komuna e Shtërpçës, ku si pasojë e këtij aksidenti shkaktohet dëm i konsiderueshëm material në të dyja veturat, ndërsa lëndime trupore pëson paditësi. Deri të aksidenti i ndodhur kishte ardhur më lëshimet ekskluzive dhe të vetme të të siguruarit të të paditurës, me çka gjatë shqyrtimit kryesor në mes ndergjygjësve edhe nuk ishte kontestuese baza e kërkesëpadisë. Sa i përket natyrës së lëndimeve trupore dhe dëmit jo material dhe material që paditësi kishte pësuar në aksidentin e ndodhur, Gjykata e shkallës së parë më nxjerrjen e provës më ekspertim mjekësor nga lëmi i neurokirurgjisë dhe psikiatrisë, ka vërtetuar se paditësi në aksidentin e ndodhur ka marrë lëndime të rënda trupore, si pasojë e ndrydhjes në regjionin e qafës dhe çarjes së brinjës IX majtas, të cilat tek paditësi kanë shkaktuar dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë qe kanë zgjatur disa sekonda, të intensitetit të rëndë qe kanë zgjatur për 12 orë dhe kohë pas kohe gjersa ka marrë terapi, të intensitetit të mesëm qe kanë zgjatur për 14 ditë dhe kohë pas kohe gjersa ka marrë terapi, të intensitetit të ultë kronike apo kohë pas kohe sipas ndryshimeve klimaterike, sforcime fizike ku i duhet të përdor ilaçe. Ka pësuar frikë primare në momentin e aksidentit qe ka zgjatur disa sekonda, frikë sekondare të intensitetit të lartë qe ka zgjatur për 2

ditë, e cila pastaj ka kaluar në frikë sekondare të intensitetit më të ultë qe ka zgjatur edhe për 3 muaj tjerë. Ka qenë e nevojshme përkujdesja e personit të tretë për 2 ditë, ushqimi i përforcuar në kohëzgjatje prej 21 dite dhe rehabilitimi fizioterapeutik ne kohëzgjatje prej 2 vitesh, 2 herë ne vit me nga 10 ditë pa përcjellës.

Duke u nisur nga kjo gjendje faktike e vërtetuar, Gjykata e shkallës së parë ka gjetur së kërkesëpadia e paditësit për dëmin jo material dhe material të kërkuar është pjesërisht e bazuar, ku edhe ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar. Mënyrën e vendosjes lidhur më dëmin jo material dhe material të gjykuar paditësit e ka bazuar në mendimin e dhënë nga ana e ekspertëve mjekësor dhe provave tjera nga shkresat e lëndës, e duke u mbështetur në dispozitat ligjore të nenit 154, 178 paragrafi 1 dhe 195 të LMD, e lidhur me nenin 323 të LPK, vendimin për kamatën e gjykuar e ka mbështetur në dispozitën e nenit 277 të LMD, ndërsa vendimin për shpenzimet e procedurës kontestimore e ka mbështetur në dispozitën e nenit 449, 452.1 dhe 453 të LPK.

Duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes Gjykata e Apelit të Kosovës, ka gjetur se Gjykata e shkallës së parë duke vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejtë ka zbatuar të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar në pjesën aprovuese të kërkesëpadiës qe ka të bëjë më kompensimin e dëmit jo material, për dhimbjet trupore-fizike, dhe frikën e shkaktuar, dhe sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, shumat e gjykuara janë në përputhje të plotë më natyrën e shpërblimit kur kihet parasysh rëndësinë e shkallës së të mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim siç është paraparë me dispozitën e nenit 200 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Marrëdhënieve të Detyrimeve ( LMD). Shpërblimi në të holla i dëmit jo material nuk është qëllim, por mjet më të cilin të dëmtuarit deri diku ja zbut pasojat e dhimbjeve fizike dhe frikës së përjetuar, të cilat sigurisht qe përbëjnë një përjetim të pakëndshëm, me çka shpërblimi në të holla të dëmtuarit do ti shërben si satisfaksion moral dhe si një përjetim i këndshëm, për zbutjen e pasojave duke i kënaqur disa nevoja të caktuara jetësore.

Sipas Gjykatës së Apelit të Kosovës, Gjykata e shkallës së parë duke vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejtë ka zbatuar të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar edhe në pjesën aprovuese të kërkesëpadiës qe ka të bëjë më kompensimin e dëmit material, për ndihmën e personit të tretë dhe ushqimin e përforcuar , ngase sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, shumat e gjykuara janë në përputhje të plotë më mendimin e dhënë nga ana e ekspertëve mjekësor dhe në mbështetje me dispozitën e nenit 195 të Ligjit të Marrëdhënieve të Detyrimeve ( LMD).

Në bazë të mendimin të ekspertëve mjekësor është vërtetuar se paditësi si pasojë e lëndimeve të marra ka pasur nevojë për përkujdesje të personit të tretë për 2 ditë dhe ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 21 dite, qe sipas kësaj Gjykate edhe kanë rezultuar me humbje materiale të paditësit, pa marrë parasysh se përkujdesjen ndaj paditësit ka mundur ta ushtron ndonjë familjar i tij apo edhe person tjetër jashtë familjes se tij i cili më kompensim është angazhuar qe të përkujdeset për paditësin gjatë kësaj periudhe dy ditore. Ndërsa sa i përket ushqimit të përforcuar, sipas Gjykatës së Apelit duke marrë parasysh natyrën e lëndimeve të cilat i ka pësuar paditësi, cili lloji i ushqimit shtesë përveç ushqimit të zakonshëm çdo ditë i është nevojitur paditësit, por edhe praktikën e gjertanishme të Gjykatave të Kosovës rreth kompensimit

për këtë lloji dëmi, kësaj Gjykata duke marrë parasysh edhe koston e çmimeve ushqimore në Kosovë, sipas bindjes së lirë të saj i ka rezultuar se për ushqim shtesë ditor paditësi ka mundur të shpenzon mesatarisht për çdo ditë prej 4 gjer ne 6 euro, me çka kur kihet parasysh kohëzgjatja prej 21 dite aq sa i është nevojitur ushqimi i përforcuar, i bie që paditësi për ushqim të përforcuar gjatë kësaj kohe ka mundur të shpenzon diku për afërsisht në shumën e cila i është gjykuar nga Gjykata e shkallës së parë, e cila është e pranueshme edhe për Gjykatën ankimore.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit e Kosovës, shuma e gjykuar nga Gjykata e shkallës së parë në pjesën aprovuese të kërkesëpadisë lidhur më dëmin material për shpenzime të mjekimit dhe shërimit rehabilitues, nuk gjen mbështetje tërësisht në provat nga shkresat e lëndës, ngase në bazë të provave nga shkresat e lëndës kësaj Gjykate i ka rezultuar se paditësi lidhur me shërimin e tij rehabilitues ka paguar shumën prej 105 euro, ndërsa për shpenzime të mjekimit ka paguar vetëm shumën prej 25.90 euro, ku kjo vërtetohet në bazë të Faturës me nr. 001541e lëshuar më datë 20.03.2010 nga ambulanca për terapi fizikale „ T ‘ ‘ në Ferizaj dhe kuponat fiskal me nr. 0011104 i datës 30.03.2010 lëshuar nga „ F ‘ ‘ në Ferizaj dhe nr. 0022159 i datës 30.03.2010 lëshuar nga Sh.a.p „ N ‘ ‘ në Ferizaj, me çka në këtë pjesë aktgjykimi i ankimuar u dashtë që të ndryshohet nga Gjykata ankimore, duke ja gjykuar paditësit shumën e tërësishtme prej 130.90 euro, ndërsa për pjesën tjetër të kërkesëpadisë për këtë kategori të dëmit material, kjo Gjykatë ka gjetur se është e pabazuar .

Gjykata e Apelit duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK ka konstatuar se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje nga neni 182.2 pika b), g), j), k) dhe m) të LPK për të cilat gjykata e ankimit kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe nuk përmban as shkelje tjera procedurale sipas pretendimeve ankimore të palës së paditur përmes ankesës së ushtruar.

Gjykata e Apelit më rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka pasur parasysh të gjitha pretendimet ankimore të palës së paditur përmes ankesës së ushtruar, ku me aprovimin e pjesshëm të tyre edhe ka ndryshuar aktgjykimin e ankimuar në pjesën lidhur më dëmin material për shpenzime të mjekimit dhe shërimit rehabilitues. Ndërsa për atë pjesë të pretendimeve ankimore të palës së paditur të cilat nuk janë marrë parasysh nga Gjykata e Apelit e Kosovës, e për të cilat ka gjetur se kryesisht i referohen lartësisë së shumave të gjykuara nga Gjykata e shkallës së parë sipas aktgjykimit të ankimuar, kjo Gjykatë ka gjetur se janë të pathemelta dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe.

Prandaj, nga të cekurat me lartë, e në mbështetje të nenit 195.1 pika d) dhe e), e lidhur me nenin 200 dhe 201 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK) u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**

**Ac.nr.3274/2013, datë 20.07.2016**

**Kryetari i Kolegjit-gjyqtari,**

**Qerim Ademaj,d.v**